

## Nxitja e proceseve këshillëdhënëse

KESE-ja nxit dhe mbështet zhvillimin e Këshillave Ekonomikë dhe Socialë ose të institucioneve të ngjashme në vendet e rajonit.

KESE-ja mbështet me vendosmëri përforcimin e dialogut social dhe dialogut civil, ose nëpërmjet mendimeve të veta, ose nëpërmjet pjesëmarrjes së anëtarëve të vet në konferenca dhe ngjarje.

## Kontaktet e rregullta

Anëtarët e KESE-së marrin pjesë në konferenca ose ngjarje të ndryshme që kanë të bëjnë me Ballkanin Perëndimor, të organizuara në Bruksel ose në rajon.

Ata takojnë gjithashtu përfaqësues të organizatave të shoqërive civile, në kuadër të vizitave studimore të organizuara në Bruksel ose të programeve të drejtuara nga institucionet e BE-së, si Programi i Vizitorëve të BE-së ose Instrumenti për Shoqërinë Civile.



**Komiteti Ekonomik dhe Social Evropian**


Rue Belliard 99  
1040 Bruxelles  
BELGIQUE

Published by: "Visits and Publications" Unit  
EESC-2018-20-SQ

[www.eesc.europa.eu](http://www.eesc.europa.eu)

Për informacione të mëtejshme, ju lutemi të na kontaktoni në:  
[balkans@eesc.europa.eu](mailto:balkans@eesc.europa.eu)

Ose vizitoni faqet tona të internetit:  
<http://www.eesc.europa.eu/en/tags/western-balkans>



© Bashkimi Evropian, 2018  
Materiali mund të riprodhohet me kusht të përmendet burimi i tij.  
© Shutterstock: america365



**SQ**

Print  
QE-02-18-191-SQ-C  
ISBN 978-92-830-3964-8  
doi:10.2864/835455

Online  
QE-02-18-191-SQ-N  
ISBN 978-92-830-3968-6  
doi:10.2864/669809



**KOMITETI EKONOMIK  
DHE SOCIAL EVROPIAN  
DHE BALLKANI  
PERËNDIMOR**

**REX**  
Marrëdhëniet  
e jashtme



**Komiteti Ekonomik dhe Social Evropian**

## KESE-ja dhe Ballkani Perëndimor: Një Qasje Dy-nivelëshe

Komiteti Ekonomik dhe Social Evropian (KESE) ka zhvilluar një qasje të dyfishtë, rajonale dhe dypalëshe, për marrëdhëniet e tija me organizatat e shoqërisë civile (OSHC) të Ballkanit Perëndimor. Të dy qasjet lidhen nga objektivat globale të përbashkëta, të cilat janë:

- dhënia e kontributit për konsolidimin e demokracisë dhe për anëtarësimin e ardhshëm në BE;
- përkrahja e dialogut civil dhe social:
  - nëpërmjet zhvillimit të një kulture dialogu mes autoriteteve dhe OSHC-ve, si dhe mes vetë OSHC-ve;
  - nëpërmjet krijimit të strukturave institucionale transparente dhe të efektshme për dialog civil dhe social;
  - nëpërmjet promovimit të krijimit të mjediseve ligjore të rinovuara për veprimtaritë e OSHC-ve;
- fuqizimi i rrjeteve të shoqërisë civile;
- rritja e shkëmbimit të përvojave dhe të praktikave më të mira.

## Qasja Rajonale

Grupi i kontaktit për Ballkanin Perëndimor - një organ i përhershëm i brendshëm i krijuar nga KESE-ja në vitin 2004 - paraqet instrumentin kryesor për koordinimin e veprimtarive të KESE-s në këtë pikëpamje. Roli i Grupit të Kontaktit është gjithashtu vëzhgimi i ndryshimeve në situatën politike, ekonomike dhe sociale në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe në marrëdhëniet mes BE-së dhe Ballkanit Perëndimor. Veç kësaj, Grupi i kontaktit promovon bashkëpunimin mes KESE-s dhe organizatave të shoqërisë civile në Ballkanin Perëndimor.

KESE gjithashtu ka miratuar mendime mbi tema me interes rajonal në Ballkanin Perëndimor, siç janë: Politika e Transportit, Zhvillimi Rural dhe Punësimi ose Politika mbi energjetikën. Vet procesi i hartimit mundësoi përforcimin e bashkëpunimit rajonal në nivel të shoqërisë civile nëpërmjet organizimit të seancave dëgjimore.

## Forumi i Shoqërisë Civile të Ballkanit Perëndimor

Forumi është pjesë e punës së Grupit të Kontaktit. Organizohet çdo dy vjet prej vitit 2006, ofron mundësi për shkëmbim të mendimeve mbi gjendjen aktuale në shoqërinë civile në rajon, nevojat e saja dhe zhvillimin e ardhshëm. Bashkon pjesëmarrës nga vendet e Ballkanit Perëndimor, anëtarë të KESE-s, përfaqësues të Këshillave Kombëtar Social dhe për Ekonomi dhe institucioneve të ngjashme, organizata ndërkombëtare sociale dhe profesionale (punëdhënës, sindikata, fermerë, konsumatorë), OJQ-ë, përfaqësues të institucioneve të BE-së dhe diplomatë. Pjesëmarrësit miratojnë përfundime që ju drejtohen autoriteteve dhe institucioneve evropiane.

Forumi i 6-të, i organizuar në korrik 2017 në Sarajevë, ju mundësoi pjesëmarrësve të diskutojnë çështje si: perspektiva e marrëdhënieve mes BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, roli i organizatave të shoqërisë civile në promovimin e rritjes së qëndrueshme dhe punësimit, migracionit, liria e të shprehurit dhe mediati, si dhe të drejtat dhe fuqizimi i grave. Mes rekomandimeve të shumta të miratuara nga pjesëmarrësit duhet të theksohet thirrja për institucionet e BE-së që të ndihmojnë vendet e rajonit akoma më shumë në zhvillimin e dialogëve social dhe civil që funksionojnë siç duhet.

## Një qasje e dyanshme

KESE gjithashtu punon në baza dypalëshe nëpërmjet hartimit të mendimeve dhe themelimit të Komiteteve të Përbashkëta Këshilluese (KPK).

## Opinionet

Si organ këshillues për institucionet e BE-së, një nga funksionet thelbësore të KESE-së është hartimi i mendimeve mbi disa politika të BE-së. Në vitin 2007, KESE-ja nisi një serë mendimesh që shqyrtonin situatën e shoqërisë civile në çdo vend të rajonit. Deri në 2015, KESE-ja nxori mendimet mbi rolin e shoqërisë civile në çdo vend.

Që të përgatitet çdo mendim, një delegacion i anëtarëve të KESE-së vizitoi vendin përkatës ku u takua me aktorët e ndryshëm dhe i përfshiu ato në hartimin e mendimit.

## Komitetet e Përbashkëta Këshilluese të Shoqërisë Civile

KESE-ja është gjithashtu e përfshirë në procesin e anëtarësimin në BE nëpërmjet themelimit të Komiteteve të Përbashkëta Këshilluese të Shoqërisë Civile (KPK). Ato plotësojnë kornizën institucionale të BE-së lidhur me secilën Marrëveshje për Stabilizim dhe Asociim (MSA) mes BE-së dhe vendit nga rajoni. Kjo ju mundëson organizatave të shoqërisë civile si nga ana e BE-së dhe nga ajo kombëtare, të vëzhgojnë procesin e anëtarësimin pas fillimit të negociatave. Paraqet një platformë dialogu për diskutimin e çështjeve me interes të përbashkët nga përfaqësuesit e shoqërisë civile. Gjithashtu i përgatit përfaqësuesit e shoqërisë civile për tu bashkuar në KESE.

KESE-ja BE e Malit të Zi dhe KESE-ja BE e Serbisë janë themeluar dhe KESE-ja mbajnë takime.

## Bashkëpunimi Ndërinstitucional

Me qëllim që të ketë qasje gjithëpërfshirëse ndaj rajonit, KESE-ja, nëpërmjet Grupeve të kontaktit, mirëmban marrëdhënie të forta me institucionet dhe agjencitë e BE-së (Komisioni Evropian, Parlamenti Evropian, Këshilli i BE-së, Komiteti për Rajone, Fondacioni Evropian për Trajnim) si dhe me organizata aktive ndërkombëtare në Ballkanin Perëndimor si: Organizata Ndërkombëtare e Punës, OSBE-ja dhe Këshilli Rajonal për Bashkëpunim.

Institucionet e BE-së mund të kërkojnë nga KESE-ja të harton mendim shpjegues mbi ndonjë temë precize, të kontribuon në përcaktimin e politikave ose programeve të BE-së. Para do kohe, Komisioni Evropian kërkoi nga KESE-ja që të harton mendim mbi "Rolin e shoqërisë civile në marrëdhëniet BE-Serbi" dhe Kryesia bullgare e Këshillit të BE-së kërkoi nga KESE-ja të harton mendim mbi "Kohezionin ekonomik dhe social dhe Integrimi evropian i Ballkanit Perëndimor – sfida dhe prioritetet".

Gjithashtu, bashkëpunimi me Delegacionet e Bashkimit Evropian në vendet e rajonit, dëshmoi të ishte i vlefshëm në nxitjen dhe zhvillimin e dialogut me organizatat e shoqërisë civile.